



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1865 Prot.

Durrës, më 21.07.2026

V E N D I M

Nr. 115, datë 21.07.2026

PËR

**"DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 8, DATË 10.02.2025 TË SENATIT AKADEMIK
"PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR CIKLIN E
PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL 2-VJEÇAR, PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE, CIKLIN E
DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL,
PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU",
DURRËS".**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 74 & 76; VKM Nr. 407 datë 01.06.2016 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim", i ndryshuar, në Urdhërat e Ministrisë së Arsimit për miratimin e hapjes së programeve, përkatësisht Urdhër nr. 529, datë 15.10.2025, Urdhër nr. 228, datë 30.06.2026 dhe Urdhër nr. 341, datë 07.07.2026; në Vendimin nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik, referuar shkresës së Fakultetit të Shkencave Politike Juridike me nr. 1859 prot., datë 17.07.2026; shkresës së Fakultetit të Edukimit me nr. 1859/1 prot., datë 17.07.2026, si dhe relacionit të Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave me nr. 1859/2 prot, datë 20.07.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave në pikën 1 të Vendimit nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik, për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për programet e reja që do të ofrohen në vitin akademik 2026-2027, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ky vendim i bashkëlidhet dhe është pjesë e pandashme e Vendimit nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik.
3. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njërive Kryesore të FSHPJ dhe FE
 - Drejtoria e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI



KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR

FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

Cikli i studimeve	Programi	Kriteret e pranimit
Bachelor	Komunikim, Teknologji dhe Media Digjitale <i>(Program i përbashkët me Universitetin "La Sapienza", Romë)</i>	Renditja e maturantëve të bëhet mbi bazën e mesatares së VKM-së ku kandidatët me rezultate më të larta të renditjes të shpallen fitues, brenda numrit të kuotave të miratuara për këtë program studimi.

KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE

FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE JURIDIKE

Cikli i studimeve	Programi	Kriteret e pranimit
Master i Shkencave	Politika Ndërkombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm <i>(Program i përbashkët me Universitetin e Teramos, Itali)</i>	Fusha e studimit të aplikantit të jenë: Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Drejtësi, Histori, Ekonomi, Administrim Publik, ose fusha të lidhura me to. Renditja të bëhet mbi bazën e mesatares së rezultateve të studimeve të ciklit të parë në rendin zbritës. Kandidatët me rezultatet më të larta të renditjes të shpallen fitues, brenda numrit të kuotave të miratuara për këtë program studimi.

FAKULTETI I EDUKIMIT

Cikli i studimeve	Programi	Kriteret e pranimit
Master i Shkencave	Psikologji Klinike <i>(Program i përbashkët me Universitetin "La Sapienza", Romë)</i>	Kandidatët të kenë përfunduar me sukses një diplomë Bachelor (180 ECTS) dhe të përzgjidhen nga institucioni i tyre i origjinës për këtë Program. Kandidatët të demonstrojnë aftësitë e tyre gjuhësore të dokumentuar në anglisht ose italisht (niveli B2 ose ekuivalenti) Shtetasit e huaj, në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe. Kandidatët, që kanë përfunduar me sukses ciklin Bachelor dhe kanë status të veçantë. Të kenë diplomë Bachelor në fushën e psikologjisë Të kenë të njohur gjuhën e huaj Anglisht ose Italisht Renditja e fituesve të bëhet bazuar tek mesatarja e aplikantëve në Bachelor